



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 102, datë 04.11.2024

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të verifikuara	I (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë "Me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës"
Konstatimet kryesore	1. AK nuk ka vepruar në përputhje me pikën 6, të nenit 21, të Ligjit Nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë" (në vijim "LPFMS"), si dhe me pikat 1 dhe 5, të nenit 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1170, datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", lidhur me dokumentimin dhe argumentimin e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ. 2. AK nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 37, të LPFMS lidhur me hartimin e kriterëve, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ. 3. AK nuk ka vepruar në përputhje me pikën 3, të nenit 44, të LPFMS, lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ.
Masat e marra	Në bazë të nenit 59, pika 1, gërma "b", të LPFMS, APP vendosi të dënojë me gjobë, 6 persona, nga të cilët: 3 persona anëtarë të grupit të punës dhe anëtarë të njësisë së prokurimit; si dhe 3 persona në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në këtë vendim.